



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"
Nr. 738-1/24 Data 24.12.2024
PRISHTINË

STATUTI I UNIONIT TË STUDENTËVE të Kolegjit BIZNESI

Prishtinë, 2024

Keshilli Studentor i Kolegjit Biznesi, në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Statutit të Kolegjit Biznesi, në mbledhjen e mbajtur më 26/12/2021, miraton:

Statutin e Unionit të Studentëve të Kolegjit BIZNESI

Neni 1 Qëllimi

1. Statuti i Unionit të Studentëve është akti më i lartë juridik i Unionit të Studentëve.
2. Statuti parasheh sigurimin e zbatimit të përgjegjësisë të Unionit të Studentëve në mbështetje të Statutit të Kolegjit Biznesi.
3. Statuti përcakton kompetencat dhe statusin e Unionit, organizimin dhe funksionimin e organeve të Unionit, marrëdhëniet brenda Unionit, bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar, marrëdhëniet e Unionit me Dekani, Këshillin e Lartë Mësimor Shkencor, studentët, parimet e përgjithshme financiare dhe dispozitat përfundimtare.
4. Statuti i Unionit të Studentëve miratohet nga Këshillin e studenteve me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 2 Unioni i Studentëve

1. Unioni i Studentëve është organizatë studentore e cila përfaqëson interesat e studentëve të Kolegjit Biznesi brenda dhe jashtë institucionit, funksionimi i të cilit është i garantuar me anë të Statutit të Kolegjit Biznesi.
2. Unioni i Studentëve, përmes organeve të tij, kujdeset që studentët t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e tyre, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, orientimi seksual, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që të gëzojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta në kushtet që ofron Kolegjit Biznesi.
3. Unioni i Studentëve mbështet bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe mundëson promovimin, mbrojtjen dhe zgjerimin e të drejtave të studentëve, duke luftuar diskriminimin, izolimin dhe padrejtësinë përmes fushatave dhe veprimeve të synuara, duke siguruar kështu përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet dhe proceset politik-bërëse dhe vendimmarrëse të Kolegjit Biznesi.
4. Unioni i Studentëve lidh marrëveshje të bashkëpunimit me organizata, institucione dhe kompani të ndryshme me qëllim të organizimit të aktiviteteve të ndryshme studentore.
5. Unioni i Studentëve iu mundëson studentëve pjesëmarrje në aktivitetet e Kolegjit përmes organeve të tij.

Neni 3 Selia

Selia e Unionit të Studentëve është në kampusin e Kolegjit Biznesi në Bulevardi "Deshmoret e Kombit nr 5 -10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Neni 4 Statusi

Unioni i Studentëve është organizatë e përfaqësimit të studentëve, pa subjektivitetet juridik, i cili përfaqëson interesat e studentëve, përmes organeve të tij.

Neni 5 Simbolet

1. Unioni i Studentëve i ka simbolet e veta përfshirë logon, vulën dhe flamurin.
2. Simbolet e Unionit të Studentëve miratohen dhe ndryshohen nga Keshilli i Studentëve në pajtim me Statutin e Kolegjit Biznesi dhe Statutin e Unionit të Studentëve, si dhe nuk u nr 5
3. Simbolet e Unionit të Studentëve ndryshohen nga Keshilli i Studentëve me 2/3 e votave të anëtarëve të Unionit të Studentëve, duke i prezantuar ato 10 ditë para mbledhjes së paraparë për votimin e ndryshimit të simboleve.
4. Përdorimi i simboleve është e drejtë ekskluzive e Unionit të Studentëve dhe asnjë subjekt apo person nuk mund ta përdorë emblemën dhe simbolet e tjera pa autorizimin paraprak nga Kryesia e Unionit të Studentëve.
5. Përmbajtja, e drejta dhe mënyra e përdorimit të simboleve të Unionit të Studentëve përcaktohet me vendime të veçanta të Keshilli të Studentëve.

Neni 6 Kompetencat e Unionit të Studentëve

1. Unioni i Studentëve i ushtron kompetencat e tij dhe ato të deleguara sipas këtij Statuti, Statutit të Kolegjit Biznesi dhe akteve tjera ligjore në fuqi.
2. Unioni i Studentëve ka kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit të përgjithshëm, duke i respektuar standardet e përcaktuara në Statut, në fushat që vijnë:
 - 2.1. Shfrytëzimin e hapësirave që ofron Kolegjit Biznesi;
 - 2.2. Promovimin, mbrojtjen dhe zgjerimin e të drejtave të studentëve;
 - 2.3. Trajtimin e kërkesave të studentëve;
 - 2.4. Organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive, dhe aktiviteteve të tjera të lira;
 - 2.5. Çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar ndonjë autoriteti tjetër.

3. Kolegjit Biznesi mund të delegojë kompetenca të caktuara për Unionin e Studentëve duke u bazuar në Statutin në fuqi.

Neni 7 Aktet e Unionit të Studentëve

1. Unioni i Studentëve harton aktet e brendshme të cilat aprovohen nga Keshilli i Studentëve.
2. Aktet e brendshme të Unionit të Studentëve vlejnë në të gjithë Kolegjin Biznesi, dega Prizren dhe përfshijnë:
 - 2.1. Statuti i Unionit të Studentëve të Kolegjit Biznesi;
 - 2.2. Rregullorja e Punës së Keshillit të Studentëve;
 - 2.3. Çdo akt tjetër i nevojshëm për funksionimin efikas të Unionit të Studentëve.

Neni 8 Fondet

1. Unioni i Studentëve ka të drejtë të posedoj dhe të menaxhoj fonde.
2. Unioni i Studentëve mbanë dhe udhëheq regjistrin e fondeve që ka në dispozicion.
3. Mjetet e ndara nga Kolegjit Biznesi do të shfrytëzohen për interesat e studentëve, si për konferenca, seminare, botime të veprave të studentëve, revista, vizita brenda dhe jashtë vendit, me qëllim të krijimit të marrëdhënieve sa më të mira me organizatat tjera studentore.

Neni 9 Bashkëpunimi me organizata të tjera studentore

1. Unioni i Studentëve ka të drejtë të bashkëpunoj dhe krijoj partneritete me organizata të tjera të Republikës së Kosovës dhe organizata ndërkombëtare, brenda fushës së kompetencave të tij, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët në pajtim me parimet e akteve ligjore.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit në emër të Unionit të Studentëve nënshkruhen nga Kryetari/Kryetarja.

Neni 10 Përfaqësimi i Unionit në asociacione

1. Për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta, Unioni i Studentëve organizohet dhe merr pjesë në asociacione që funksionojnë brenda dhe jashtë vendit.
2. Aktet e anëtarësimit, dokumentet financiare të asociacioneve, informacionin për aktivitetet dhe kontributet e tyre buxhetore në asociacione, kryesia e Unionit të Studentëve duhet t'i bëjë publike para Keshilli të Studentëve për aprovim.

3. Në pajtim me ligjin, asociacionet e tilla mund t'iu ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë trajnime, ngritjen e kapaciteteve, ndihmë teknike, hulumtime, etj.

4. Asociacionet e organizatave studentore mund të bashkëpunojnë me asociacionet ndërkombëtare.

Neni 11 **Struktura organizative**

1. Struktura organizative e Unionit të Studentëve është si në vijim:

- 1.1. Këshilli i Studentëve
- 1.2. Kryesia
- 1.3. Kryetari i Unionit të Studentëve
- 1.4. Kryetari i Unionit të Studentëve të Programit
- 1.5. Komisionet
- 1.6. Anëtarët e Unionit të Studentëve.

Keshilli i Studentëve

Neni 12

- 1. Keshilli i Studentëve është organi më i lartë përfaqësues i studentëve.
- 2. Keshilli i Studentëve përbëhet nga:
 - 2.1. një (1) përfaqësues i zgjedhur nga secili Program Studimor.
 - 2.2. një (1) përfaqësues i rezervuar për studentët e komuniteteve jo shumicë.
- 3. Keshilli i Studentëve harton dhe aprovon Rregulloren e Punës së Keshillit të Studentëve.
- 4. Keshilli i Studentëve miraton Statutin e Unionit të Studentëve dhe aktet e tjera të Unionit.
- 5. Keshilli i Studentëve dhe Kryesia e Unionit kanë të drejtë të ndërmarrin masa për zbatimin e akteve ligjore brenda fushës së kompetencave të tyre.
- 6. Keshilli i Studentëve udhëhiqet nga Kryetari/ja e Unionit të Studentëve.

Neni 13 **Mbledhjet e Keshillit të Studentëve**

Mbledhjet e Keshillit të Studentëve thirren nga Sekretari/ja i/e Unionit të Studentëve, më së paku 3 ditë para ditës së paraparë për takim, përjashtuar rastet emergjente.

Neni 14 **Zgjedhjet për Keshillin e Studentëve**

1. Anëtarët e Keshilli të Studentëve, si organ i pavarur, zgjedhën nga votat e studentëve të Kolegjit Biznesi, në zgjedhjet studentore të cilat mbahet çdo tri vite.
2. Zgjedhjet mund të jenë të rregullta, të jashtëzakonshme dhe të parakohshme.
3. Zgjedhjet organizohen nga Kryesia e Unionit Studentor.

Neni 15

Kandidimi për anëtarë të Keshillit të Studentëve

1. Kandidat për anëtarë të Keshillit të Studentëve mund të jenë të gjithë studentët e PS të Kolegjit Biznesi, dhe dega Prizren.
2. Kandidatët për anëtarë të Keshillit të Studentëve duhet t'i plotësojnë kriteret e paracaktuara si në vijim:
 - 2.1. Studenti/ja duhet të jetë në vitin e I ose II të studimeve në sistemin 3 vjeçar, ndërsa në sistemin 4 vjeçar student duhet të jetë në vitin e I, II ose III.

Neni 16

Procesi zgjedhor

1. Procesi zgjedhor shpallet dhe menaxhohet nga Kryesia aktuale e Unionit.
2. Me shpalljen e zgjedhjeve nga Kryesia e Unionit, secili student ka të drejtë të kandidohet duke i siguruar së paku 50 nënshkrime nga studentët të fakultetit përkatës.
3. Lista me nënshkrime duhet të përmbajë numrin e kartelës studentore me qëllim të evitimit të nënshkrimit të dyfishtë.
4. Lista me nënshkrime i dorëzohet Kryesisë së Unionit, e cila pas verifikimit të rregullsisë së listës së nënshkrimeve dhe kandidaturave, vendos emrat e të gjithë kandidatëve për votim.
5. Votimi organizohet në formë elektronike përmes platformës E-Studenti.
6. Procesi zgjedhor zgjatë 7 (shtatë) ditë.
7. Studenti/ja me më së shumti vota zgjedhet Kryetar i Unionit të Studentëve të Fakultetit përkatës dhe përfaqëson studentët e atij fakulteti në Keshillin e Studentëve.
8. Studenti i cili radhitet i dyti për nga votat, zgjedhet nën kryetar i Unionit të Studentëve të Fakultetit.
9. Kryetari dhe nënkryetari i Unionit të Studentëve të Fakultetit përkatës përfaqësojnë studentët në Keshillin e Larte Mësimor Shkencor të Kolegjit Biznesi.

10. Dy nga studentët me më së shumt vota në nivel të degës zgjedhën përfaqësues të studentëve të degës në Keshillin e Studentëve.

11. Mandati i anëtarëve të Keshillit të Studentëve është dy vjeçar.

Neni 17

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Keshillit të Studentëve

1. Anëtarët e Keshillit të Studentëve kanë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, të cilat sipas Statutit të Unionit të Studentëve parashihen të jenë:

- 1.1. Marrin pjesë aktive në takimet e Keshillit të Studentëve;
- 1.2. Angazhohen në komisionet e Keshillit të Studentëve;
- 1.3. Kryejnë detyrat e përcaktuara nga Kryetari/ja i/e Unionit të Studentëve;
- 1.4. Marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga Unioni i Studentëve apo Kolegji Biznesi;
- 1.5. Raportojnë para Keshillit të Studentëve, në periudha 3 mujore ose me kërkesë nga anëtarët.

Neni 18

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Keshillit të Studentëve

1. Mandatit i anëtarëve të Keshillit të Studentëve përfundon nëse:

- 1.1. Shkelin Statutin e Unionit të Studentëve të Kolegjit Biznesi;
- 1.2. Shkelin Rregulloren e Punës së Keshillit të Studentëve ose aktet e tjera;
- 1.3. Japin dorëheqje;
- 1.4. Në rast të mungesave dhe mos angazhimit të vazhdueshëm;
- 1.5. Me përfundim të mandatit;
- 1.6. Në rast të refuzimit për raportim para Unionit të Studentëve (mbi dy herë radhazi);
- 1.7. Me iniciativë të së paku 1/4 anëtarëve të Unionit të Studentëve të cilët faktojnë sjelljen ose qëndrimin joadekuat të anëtarëve;
- 1.8. Me vdekje.

Neni 19

Kryesia

Kryesia e Unionit të Studentëve përbëhet nga:

1. Kryetari/ja i/e Unionit të Studentëve;
2. Dy(2) nënkryetarët e Unionit të Studentëve nga kampuset Prishtinë, Prizren
3. nga një përfaqësues i çdo Programi

Neni 20

Zgjedhja e Kryetarit/es të Unionit të Studentëve

1. Procedura e zgjedhjes së kryetarit/es të Unionit të Studentëve përcaktohet si në vijim:

- 1.1. Kryetari/ja e Unionit të Studentëve zgjedhet nga Keshilli i Studentëve me 50 + 1 % të votave dhe mandati i tij/saj zgjat dy vite.
- 1.2. Anëtarët e Keshilli të Studentëve të cilët synojnë postin e Kryetarit/es së Unionit të Studentëve, propozohen nga anëtarët e tjerë të Keshilli të Studentëve apo vet propozohen, me kusht që të kenë së paku 3 nënshkrime nga anëtarët, për të qenë kandidat për kryetar/e të Unionit.
- 1.3. Kandidatët për postin e Kryetarit/es të Unionit të Studentëve e kanë të paracaktuar një (1) ditë për të shpalosur plan programin e tyre para anëtarëve të tjerë të Keshillit të Studentëve në formë prezantimi.
- 1.4. Anëtari i Keshilli të Studentëve ka të drejtë të jap nënshkrimin për vetëm një kandidaturë.
- 1.5. Nëse në raundin e parë, asnjëri nga kandidatët nuk i siguron 50+1% të votave, atëherë në raundin e dytë shkojnë për votim dy kandidatët të cilët kanë siguruar më së shumti vota në raundin e parë.
- 1.6. Në raundin e dytë, për Kryetar të Unionit të Studentëve, zgjedhet kandidati i cili ka siguruar 50+1% të votave nga anëtarët e Keshillit të Studentëve.

Neni 21

Kriteret për zgjedhjen e Kryetarit/es

1. Kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët për postin e Kryetarit/es të Unionit të Studentëve janë si në vijim:
 - 1.1. Studenti/ja duhet të jetë në vitin e I ose II të studimeve në sistemin 3 vjeçar, ndërsa në sistemin 4 vjeçar student/ja mund të jetë edhe në vitin III në programet e studimit të Kolegjit Biznesi.
 - 1.2. Të jetë student/e i/e rregullt.
 - 1.3. Kandidatët për kryetar/e të Unionit të Studentëve nuk duhet të jenë të përfshirë në punë administrative brenda Kolegjit Biznesi.

Neni 22

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit/es së Unionit të Studentëve

1. Detyrat e Kryetarit/es së Unionit të Studentëve janë:
 - 1.1. Kryetari/ja është autoriteti kryesor drejtues i Unionit të Studentëve;
 - 1.2. Përfaqëson studentët e Kolegjit Biznesi brenda dhe jashtë institucionit;
 - 1.3. Organizon dhe udhëheq punën e Keshilli të Studentëve;
 - 1.4. Udhëheq takimet e Keshilli të Studentëve;
 - 1.5. Mbikëqyrë punën e anëtarëve të Unionit të Studentëve;
 - 1.6. Ekzekuton aktet e miratuara nga Keshilli i Studentëve;
 - 1.7. Propozon anëtarët e komisioneve në Keshilli e Studentëve;
 - 1.8. Propozon rregullore dhe akte të tjera për miratim në Keshilli e Studentëve;
 - 1.9. Propozon Planin e Punës së Keshilli e Studentëve dhe ekzekuton të njëjtin me anëtarët e tjerë të Unionit;
 - 1.10. Raporton për zhvillimet brenda Keshilli, zbatueshmërinë e Planit të Punës, rrjedhën e aktiviteteve dhe të tjera, së paku njëherë në gjashtë muaj, apo kur kërkohet nga anëtarët e Unionit të Studentëve;
 - 1.11. Kërkon që Keshilli i Studentëve të shqyrtoj aktet e propozuara për miratim;

- 1.12. Delegon përgjegjësi tek anëtarët e tjerë varësisht nga sfera e punës së anëtarëve;
- 1.13. Organizon aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Unionit dhe Kolegjit Biznesi;
- 1.14. Emëron përfaqësuesit e Unionit të Studentëve në trupat akademike të Kolegjit Biznesi.
- 1.15. Përfaqëson Unionin e Studentëve në Këshillin Drejtues të Kolegjit Biznesi.

Neni 23

Përfundimi i mandatit të Kryetarit/es së Unionit të Studentëve

1. Mandati i Kryetarit/es të Unionit të Studentëve mund të përfundojë para kohe nëse:

- 1.1. Shkel Statutin e Unionit të Studentëve;
- 1.2. Shkelin Rregulloren e Punës së Keshilli të Studentëve ose aktet e tjera;
- 1.3. Me dorëheqje;
- 1.4. Në rast të mungesave dhe mos angazhimit të vazhdueshëm;
- 1.5. Në rast të refuzimit për raportim para Anëtarëve të Keshilli të Studentëve (mbi dy herë radhazi);
- 1.6. Me iniciativë të së paku 1/4 anëtarëve të Unionit të Studentëve të cilët faktojnë sjelljen ose qëndrimin joadekuat të Kryetarit/es sipas pikave 1.1., 1.2. dhe 1.4. të këtij neni.

Neni 24

Nënkryetarët e Unionit të Studentëve

1. Nën kryetari i Unionit të Studentëve nga kampusi Prishtinë zgjedhet sipas procedurës së njëjtë të zgjedhjes së Kryetarit/es të Unionit të Studentëve.
2. Përfaqësuesit e zgjedhur në Keshilli e Studentëve nga dega e Prizrenit, sipas detyrës zyrtare janë nën kryetar të Unionit të Studentëve me rotacionin, me mandat një vjeçar.

Neni 25

Detyrat dhe përgjegjësitë e Nënkryetarëve të Unionit të Studentëve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetarëve të Unionit të Studentëve:

- 1.1. Zëvendësojnë Kryetarin/en në takime në rast mungese ose me autorizim nga Kryetari/ja;
- 1.2. Angazhohen në hartimin e Planit të Punës dhe akteve tjera të Keshilli;
- 1.3. Raportojnë para Kryesisë dhe Keshilli të Studentëve në periudha tre mujore ose sipas kërkesës të anëtarëve të tjerë;
- 1.4. Ekzekutojnë aktet e miratuara nga Keshilli i Studentëve;
- 1.5. Propozojnë rregullore dhe akte tjera për miratim nga Keshilli i Studentëve;
- 1.6. Kryejnë përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kryetari/ja;
- 1.7. Veprojnë në koordinim të plotë me Kryetarin/en e Unionit të Studentëve.

Neni 26

Përfundimi i mandatit të Nënkyetarëve të Unionit të Studentëve

Procedura e përfundimit të mandatit të Nënkyetarëve të Unionit të Studentëve është e njëjtë me procedurën e përfundimit të mandatit të Kryetarit/es sipas Neni 23 të këtij Statuti.

Neni 27

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit/es të Unionit të Studentëve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit/es së Unionit të Studentëve janë:

1.1 Thërret takimet e Keshilli të Studentëve;

1.2 Cakton Pikat e Rendit të Ditës dhe merret me evidencën e pjesëmarrjes së anëtarëve në takime;

1.3 Organizon dhe udhëheq me punët administrative, financiare, logjistike, etj., të Keshilli të Studentëve;

1.4 Raporton para Keshilli të Studentëve vetëm me kërkesë nga Kryetari/ja ose anëtarët.

Dispozitat përfundimtare

Neni 28

Në pajtim me këtë Statut dhe Statutin e Kolegjit Biznesi hartohen të gjitha aktet tjera të përgjithshme dhe të veçanta të Unionit të Studentëve.

Neni 28

1. Statuti i Unionit të Studentëve mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të tij.

2. Ky Statut hynë në fuqi nga dita e miratimit të tij në Keshillin e Studentëve.

Kryetar i Unionit të Studentëve

Bamir Spahiu


